



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë: 27 janar 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1677_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, Nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës Nr. 04/2017 për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rregullës për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë;
- Rregullës së procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në burimet ripërtëritshme të energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_2323_06_22.

në seancën e mbajtur më datë 27 janar 2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** - ankesa e konsumatorit **Bashkim Prevlukaj, Mabeko Group SH.P.K** nga Komuna e Pejës, si në arsyetim të këtij vendimi.
- II. **Mbetet në fuqi** Pëlqimi Elektroenergjetik i lëshuar nga KEDS Nr.1216 i datës 18.02.2022.

A r s y e t i m

Konsumatori **Bashkim Prevlukaj, Mabeko Group SH.P.K** në ankesën e tij drejtuar DMK-së pranë ZRRE-së, me datë 15.04.2022 ka apeluar përgjigjen e KEDS-it – Divizioni i Pëlqimeve Elektroenergjetike – Departamenti për Konsumatorë të datës 05.04.2022 për shkak të mos dhënies së Pëlqimit Elektroenergjetik (PEE) për kyçjen e sistemit fotovoltaik për vet-konsum sipas kushteve të PEE nr.12756 të datës 16.11.2018.

Me datë 03.02.2022 konsumatori **Bashkim Prevlukaj, "Mabeko Group SH.P.K"** (i autorizuari kompania "Elen" N.T.SH) bazuar në "Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në burimet e ripërtëritshme të energjisë", ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEDS për kyçjen e sistemit fotovoltaik për vet-konsum, me kapacitet prej 92.40 kWp.
Provë: Kërkesa e konsumatorit e datës 03.02.2022.

Me datë 18.02.2022 KEDS i ka lëshuar konsumatorit **Bashkim Prevlukaj, Mabeko Group SH.P.K** Pëlqimin Elektroenergjetik nr.1216, ku theksohet se: Investitori paraprakisht është i pajisur me PEE nr.12756 të datës 16.11.2018 për furnizimin e fabrikës për prodhimin e gypave të ventilimit. Tani investitori kërkon Pëlqim Elektroenergjetik për kyçje të sistemit solar për vet-konsum. Sipas udhëzimeve të komisionit teknik të KEDS është vlerësuar si kriter që fuqia maksimale gjeneruese të jetë 30% e fuqisë nominale të transformatorit distributiv, andaj KEDS lëshon PEE sipas kushteve të mëposhtme teknike. Në



Pëlqimin Elektroenergjetik janë dhënë edhe kushtet teknike për për kyçjen e sistemit fotovoltaik për vet-konsum.

A. Kushtet Energjetike

Veprimtaria: Konsumatorë vet – prodhues

Fuqia e instaluar e TS: $S_{inst}=160$ kVa

Fuqia P_{max} si konsumatorë: $P_{mnj}=98.16$ kW

Fuqia P_{max} e kërkuar si konsumatorë vet-prodhues $P_{mnj}=48$ kW.

Provë: Pëlqimi Elektroenergjetik Nr.1216 i datës 18.02.2022

Konsumatori Bashkim Prevlukaj, "Mabeko Group SH.P.K", ka kundërshtuar PEE nr.Nr.1216 të datës 18.02.2022 të lëshuar nga KEDS, duke kërkuar që t'i lëshohet pëlqimi për kyçje e sistemit fotovoltaik për vet-konsum sipas PEE nr.12756 të datës 16.11.2018, dhe atë me kapacitet prej 92,40 kWp, pasi që konsumatori ka të aprovuar fuqinë e njëkohshme prej 98.16 kW me PEE nr.12756 të datës 16.11.2018.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KEDS

Pas ankesës së konsumatorit, Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 05.04.2022 i është përgjigjur konsumatorit duke i lëshuar përgjigjen, dhe duke i theksuar se ka shqyrtuar kërkesën e konsumatorit për revidimin e PPE nr. 1216 të datë 18.02.2022 ku ka potencuar se Mabeko Group SH.P.K ka fuqi të kontraktuar si konsumator i energjisë elektrike prej $P_{mnj}=98.16$ kW me PEE nr.12756 të datës 16.11.2018, mirëpo kërkesën tuaj për fuqinë maksimale si konsumatorë prodhues prej 92.40 kWp, KEDS e ka vlerësuar bazuar në profilin e konsumatorit për vitin 2021, si dhe fuqinë e instaluar te transformatorit distributor prej nga furnizoheni si konsumatorë. Fuqia maksimale e arritur për vitin 2021 ka qenë 46.70 kW si dhe bazuar në profilin e ngarkesës fuqia aktive sillet deri në 20 kW mbi 90% të kohës, kështu që për Mabeko Group SH.P.K është vlerësuar si optimale për vet-konsum fuqia e maksimale e gjeneruese prej 48 kW pasi që edhe në vlerësimin vjetor të prodhimit nga gjeneratori fotovoltaik është përafërsisht rreth 60,000 kWh/vit, kurse konsumi total gjatë vitit 2021 ka qenë 46794.30 kWh/vit. Po ashtu në përgjigje është evidentuar se në projektin elektrik të dorëzuar nga konsumatori (personi i autorizuar) se bashku me pëlqimin Elektroenergjetik në pjesën e vlerësimit të prodhimit të energjisë nga gjeneratori si kapacitet i propozuar ka qenë 52.90 kWp me prodhim vjetor të vlerësuar 59,496 kWh/vit, andaj edhe Pëlqimi elektroenergjetik nr. 1216 datë 18.02.2022 mbetet në fuqi.

Provë: Përgjigja e KEDS-it e datës 05.04.2022

Me datë 15.04.2022 konsumatori në DMK të ZRRE-së ka apeluar përgjigjen e KEDS-it, Divizioni i Pëlqimeve Elektroenergjetike – Departamenti për Konsumatorë të datës 05.04.2022 për shkak të mos dhënies së pëlqimit elektroenergjetik për kyçje e sistemit fotovoltaik për vet-konsum sipas PEE nr.12756 të datës 16.11.2018.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 24.02.2022

Bordi i ZRRE-së, ka administruar të gjitha provat, dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, KEDS si dhe rekomandimin e DMK-së, dhe ka vlerësuar se:

Konsumatori Bashkim Prevlukaj, "Mabeko Group SH.P.K"(i autorizuar kompania "Elen"N.T.SH) me datë 03.02.2022 bazuar në legjisllacionin në fuqi ka parashtruar kërkesë te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – KEDS për Pëlqim Elektroenergjetik lidhur me për kyçjen e sistemit fotovoltaik për vet-konsum sipas PEE nr.12756 të datës 16.11.2018 me kapacitet prej 92.40 kWp.

Provë: Kërkesa e konsumatorit për PEE e datës 03.02.2022,

Bazuar në kërkesën e konsumatorit, KEDS me datë 18.02.2022 ka lëshuar aplikuesit Pëlqimin Elektroenergjetik nr.1216, me të gjitha kushtet teknike, si dhe i theksuar se edhe përkundër që konsumatori ka PEE nr.12756 të datës 16.11.2018 si konsumator me kapacitet prej 98.16 kW, KEDS



bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe kriteret e vlerësuara, të dhënat e konsumatorit, vlerëson se kapaciteti maksimal si konsumator vet-prodhues duhet të jetë 48 kW.

Provë: Pëlqimi Elektroenergjetik nr.1216 i datës 18.02.2022

Pas dhënies së PEE nga ana e KEDS, konsumatori Bashkim Prelvukaj, "Mabeko Group SH.P.K", nuk është pajtuar me PEE nr.Nr.1216 të datës 18.02.2022 të lëshuar nga KEDS dhe ka parashtruar ankesë. Departamenti për Konsumator në KEDS i ka kthyer përgjigje konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit dhe duke i theksuar se sipas të dhënave të vitit 2021, fuqia maksimale ka qenë **46.70 kW** si dhe bazuar në profilin e ngarkesës fuqia aktive sillet deri në 20 kW mbi 90% të kohës. Gjithashtu në përgjigje është theksuar se sipas dokumentacionit të ofruar dhe të dhënave vlerësimi vjetor i prodhimit nga gjeneratori fotovoltaiik është përafërsisht rreth 60,000 kWh/vit kurse konsumi total gjate vitit 2021 ka qenë 46,794.30 kWh/vit.

Provë: Ankesa e konsumatorit, PEE Nr.1216 datë 18.02.2022 dhe përgjigja e KEDS e datës 05.04.2022

ZRRE me datë 01.03.2022 i është drejtuar KEDS përmes shkresës elektronike për informata shtesë lidhur me kërkesën e konsumatorit ku ka potencuar se: *"ZRRE ka pranuar ankesën nga kompania "Elen" për konsumatorin "Bashkim Prelvukaj" MABEKO GROUO SH.P.K, lidhur me kufizimin e fuqisë se instaluar. Sipas dokumentacionit të ofruar nga kompania shihet se konsumatori "Bashkim Prelvukaj" MABEKO GROUO SH.P.K ka të lëshuar PPE nr. 12756 datë 16.11.2018 me fuqi maksimale të njëkohshme prej 98.16 kW kurse me datë 18.02.2022 i është lëshuar PPE nr. 1216 me fuqi maksimale të njëkohshme prej 48 kW edhe përkundër faktit që kërkesa është bere për pëlqim për kyçje në rrjetin elektrik të Sistemit Solar Fotovoltaiik me kapacitet 92.40 kWp".*

Provë: Kërkesa e ZRRE e datës 01.03.2022

Me datë 28.03.2022 KEDS përmes shkresës elektronike ka dërguar sqarimet e kërkuara e ku thuhet se: sipas Rregullës për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, citojmë: *konsumator prodhues është konsumatori i energjisë elektrike që në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin lokacion është pronar i mikro-gjeneratorit të BRE-ve".* Ky konsumator vet-prodhues i kyçur në rrjet ka të drejtë të vet-konsumit të energjisë elektrike të gjeneruar si dhe dërgimin e tepicës së energjisë elektrike të gjeneruar tek furnizuesi përmes rrjetit të distribucionit. Në Nenin 20 të Rregullës përkatëse theksohet se: *"Aplikimi i gjeneratorëve për vetë-konsum dhe procedura e kyçjes, paragrafi 1, "thotë që çdo konsumator i energjisë elektrike i kyçur në tensionin e ulët të rrjetit të shpërndarjes mund të aplikoj tek furnizuesi i tij për marrjen e statusit të konsumatorit prodhues, në përputhje me Rregullën për Procedurën e Autorizimit".*

Provë: Sqarimet e KEDS të datës 28.03.2022

Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë legjislacionit në fuqi thekson se në Nenin 2, par. 1, nënpar. 1.9 të Rregullës për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, është dhënë definicioni Konsumatorit Prodhues: *"është konsumatori i energjisë elektrike që në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin lokacion është pronar i mikro-gjeneratorit të BRE-ve, të kyçur në rrjet dhe me të drejtë të vetë-konsumit të energjisë elektrike të gjeneruar si dhe dërgimin e tepicës së energjisë elektrike të gjeneruar tek furnizuesi".* Neni 2, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 i të njëjtës Rregull e përcakton definicionin e gjeneratorit të vogël të BRE, e ku definicioni është: *"nënkupton gjeneratorin e kyçur në rrjet me kapacitet deri në 100 kW (≤ 100 kW)".*

Kreu V i Rregullës për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, përshkruan në detale përfshirjen në skemën mbështetëse të konsumatorëve vet-prodhues, duke filluar nga parimet e gjeneratorëve për vetë-konsum të energjisë elektrike, metodologjinë e llogaritjes së energjisë së prodhuar nga gjeneratorët për vetë-konsum, aplikimi i gjeneratorëve për vetë-konsum dhe procedura e kyçjes. Në Nenin 20, paragrafi 1 i Rregullës së lartcekur thuhet: *"Çdo konsumator i energjisë elektrike i kyçur në tensionin e ulët të rrjetit të shpërndarjes mund të aplikoj tek*



furnizuesi i tij për marrjen e statutit të konsumatorit prodhues, në përputhje me Neni 25 të Rregullës së Procedurës së Autorizimit dhe në përputhje me formularin e aplikimit në Shtojcën 3 dhe të njëjtin aplikacion duhet ta dorëzojë në Rregullator”.

Kreu V i Rregullës së procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në burimet ripërtritshme të energjisë, përshkruan në detale aplikimin e gjeneratorëve për vet-konsum, ku më saktësisht Neni 25 përshkruan dëshmitë që duhet të dorëzohen në Rregullator për marrjen e statusit të konsumatorit vet-prodhues, e ku dëshmitë të cilat duhet të dorëzohen janë: dëshmia nga KEDS për konsumin e energjisë vjetore, vlerësimin për prodhimin vjetor në kWh të pajisjeve të instaluar, Pëlqimi për kyçje në rrjet i lëshuar nga KEDS, si dhe pëlqimi nga komuna përkatëse.

Sipas analizave të bëra të dhënave të bëra konsumatorit me shifër DPE – 9064146 vërehet se në vitin 2021 fuqia maksimale (kapaciteti maksimal) ka arritur 46.70 kW, ndërsa në 90% të kohës është sillur rreth 20 kW. Pra shihet qartë se fuqia maksimale e arritur gjatë vitit 2021 prej 46.70 kW nuk përputhet as për së afërmi me kërkesën e kërkuar nga aplikuesi prej 98.16 kW. Gjithashtu sipas të dhënave të konsumatorit në fjalë, shihet se konsumi total gjatë vitit 2021 ka qenë 46794.30 kWh/vit, ndërsa sipas të dhënave të vlerësimit të prodhimit nga gjeneratori fotovoltaik është 59469 kWh/vit. ZRRE ka analizuar edhe të dhënat e konsumatorit për vitin 2020, ku shihet se në vitin 2020 fuqia maksimale e arritur ka qenë 36.22 kW, ndërsa konsumi total gjatë vitit 2020 ka qenë 25574.80 kWh/vit. Pra edhe nga analiza e të dhënave të vitit 2020 shihet qartë se as fuqia maksimale e as konsumi nuk përputhen me kërkesën e konsumatorit dhe vlerësimin e prodhimit nga gjeneratorin fotovoltaik.

Bazuar në dispozitat ligjore të aplikueshme për burimet e ripërtritshme të energjisë, një aplikues mund të merr statusin e konsumatorit vet-prodhues në rast se plotëson kriteret e përcaktuara në këto Rregulla, e që janë që kapaciteti maksimal i cili lejohet është 100 kW, kyçja duhet të jetë në tensionin e ulët të rrjetit të shpërndarjes, si dhe aplikuesi duhet të plotësoj dokumentet e lartcekura, e që një prej dëshmive të rëndësishme është edhe konsumi i energjisë elektrike. Pra, duhet theksuar se sipas dispozitave ligjore të lartcekura, konsumatori vet-prodhues është ai konsumator i energjisë elektrike i cili përveç kriterëve të përshkruara më lartë, prodhon energji elektrike për të mbuluar konsumin e tij dhe eventualisht tepriçën ta injektoj në rrjetin e shpërndarjes dhe për atë bilanc pozitiv konsumatori kreditohet për faturimin e ardhshëm.

Andaj Bordi i ZRRE, mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ankesën dhe të dhënat e konsumatorit për fuqinë maksimale të shfrytëzuar, konsumin e energjisë elektrike dhe vlerësimin e prodhimit nga gjeneratori fotovoltaik, shkresat e lëndës, përgjigjen e KEDS, vlerësimin e rekomandimit të DMK-së, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: **Bashkim Prevlukaj, Mabeko Group SH.P.K**
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.